

Konsistenca Ndërmjet Rezultateve të Test-Trakave dhe Mikroskopit të Parametrit e Analizës së Urinës

Berna Ibrahim¹, Dua Danjoll², Alban Fejza³

Abstrakti

Hyrja: Test traka është një metodë e shpejtë, e lehtë dhe e lirë për diagnozën dhe ndjekjen e disa sëmundjeve, rezultatet janë mjaft heterogjene dhe mund të ndikohen nga faktorë të jashtëm. Sensibiliteti dhe specifika e shiritave të provës së urinës është gjerësisht e ndryshueshme.

Metodologjia: Pjesëmarrës në këtë hulumtim ishin laborantë mjekësorë të cilët punojnë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, në Qendrën e Mjekësisë Familjare si dhe në Laboratore private. Në hulumtimin e realizuar janë plotësuar 30 pyetësor që i përgjigjen qëndrimeve të laborantëve mjekësor ndaj besimit të trakave dhe 320 formular për krahasimin e rezultateve diagnostike ndërmjet test trakave dhe mikroskopit.

Rezultatet: Tek leukocitet, vërehen dallime ndërmjet rezultateve të analizave të matura me test-trakë dhe me mikroskop. Sipas rezultateve, 71.4% e rasteve kanë rezultuar negative sa i përket leukociteve në urinë. Në anën tjetër kur kjo është matur me mikroskop, vetëm 12.9% kanë rezultuar negative. Ndërsa sa i përket eritrociteve në urinë, 81.8% e të rasteve kanë rezultuar negative. Në anën tjetër kur kjo është matur me mikroskop, vetëm 64.5% kanë rezultuar negative. Te matja e Bilirubinës, vërehen dallime ndërmjet rezultateve të analizave të matura me test- trakë dhe me reagjentë, ku 95.9% e rasteve kanë rezultuar negative sa i përket bilirubinave në urinë. Ndërsa kur është bërë matja me reagjentë, vetëm 86.8% kanë rezultuar negative. Sa i përket besueshmërisë, 37.1% laborantë krahasojnë rezultatet e Test Trakes me Mikroskop dhe vetëm 0.9% nuk i aplikojnë të dy metodat e krahasimit të parametrave të urinës. 19.5 % e laborateve gjithmonë kanë test traka të pranishme në laborator, 10.1% e tyre rrallë herë ndodh që të mos kenë test traka dhe vetëm 0.9% ndodh që shpesh kanë mungesë të tyre. 31.1 % e laborantëve përdorin çdo herë Test Trakat dhe vetëm 0.9% e laborantëve i përdorin vetëm në raste patologjike.

Rekomandimet: Rekomandohet të ngritet vetëdijësimi i laborantëve për dallimet specifike që mund të ekzistojnë ndërmjet këtyre dy metodave. Në ndërkohë sygjerohet përdorimi i të dyja metodave (test-trakës dhe mikroskopit). Të hulumtohen më tutje aspektet që lidhen me këto dy metoda të matjes së parametrave të urinës.

Fjalët kyqe: Test-traka, mikroskopi, besueshmeria, urina